Lexoni me kujdes, analizoni me mençuri!

Sot jemi në një situatë kur jemi të detyruar të distancohemi me rrethin social dhe të jemi përgjegjës për të parandaluar përhapjen e koronavirusit. Qeveria po merr masa që kufizojnë kohën tonë për të dalë jashtë. Gjatë izolimit, çdo person, pavarësisht nëse e pëlqen apo jo, është pothuajse gjithmonë në kontakt me të gjitha lajmet e ofruara nga mediat, përkatësisht numrin dhe vendndodhjet e personave të infektuar, kushtet në karantinat shtetërore, simptomat e virusit, masat parandaluese, mbrojtje, analiza epidemiologjike, mënyra të pakonfirmuara dhe të konfirmuara për të trajtuar sëmundjen. Njerëzit I shpërndajnë këto lajme dhe nuk kontrollojnë burimin dhe besueshmërinë e informacionit. Publiku i gjerë është akoma i udhëhequr nga praktika e njohur që në të vërtetë duhet të zbatohet në çdo rrethanë, dhe kjo është: lajmet që përcillen përmes mediave duhet së pari të verifikohen, aprovohen dhe shpërndahen para audiencës si informacion relevant. I tillë është perceptimi i brezave dhe gjeneratave të më parshme. Por me shpejtësinë e internetit, i gjithë procesi është shkelur dhe informacionet ashtu siç janë po bëhen publike.

Studimi francez mbi kombinimin e ilaçeve të malaries dhe antibiotikut azitromicinë , ose "sumamed" për të luftuar koronavirusin, është përhapur në të gjitha mediat në botë, përfshirë edhe këtu te ne . Ata thanë se ky kombinim mund të veprojë kundër sëmundjes, kështu që i bëri autoritetet shëndetësore maqedonase të mendojnë për përdorimin e mundshëm të këtyre ilaçeve.



Rreth pesëmbëdhjetë ditëve më parë, kjo terapi kishte filluar të haset te pacientët me sëmundje. Sidoqoftë, si reaguan disa nga qytetarët ndaj këtij lajmi dhe çfarë i bëri të ndërmarrin i njejti informacion ?



Prandaj, shtrohet pyetja se sa janë në gjendje qytetarët të ansorbojnë informacionin e cila në kohën e pandemisë dhe situatës së krizës në një farë mënyre ofron "shpëtim" dhe një kurë të mundshme në luftën kundër virusit? Duke marrë parasysh vetëm titullin, ata ndërtojnë mendimet dhe pikëpamjet e tyre bazuar në të, pa lexuar me kujdes të gjithë tekstin. **Dhe normalisht, një qasje e tillë nuk çon në faktin e trishtuar se ne në përgjithësi jemi shumë të prekshëm në fushën e leximit mediatik dhe të menduarit kritik.** Dekada me radhë njerëzit janë mësuar të lexojnë dhe të dëgjojnë lajme në mënyrë selektive. Mendimi kritik dhe analitik nuk është I nxitur në to, dhe vetëdija nuk është zhvilluar në shkallën e duhur.

Pikërisht për shkak të pasojave të tilla të mundshme si pasojë e frikës dhe panikut të tanishëm që po përhapet në publikun e gjerë, gazetarët, pavarësisht se kanë për detyrë të ofrojnë informata në kohë reale për lexuesit, para se gjithash kanë edhe detyrim moral ta bëjnë këtë me një ton që nuk do t'i tremb njerëzit, dhe as nuk do të zvogëlojë seriozitetin e situatës. Realisht është e nevojshme të shmangni frazat senzacionale dhe të "përpunohen" informacione komplekse si ajo e mëparshmja e përmendur në këtë rast. Dhe po, gazetarët, tani më shumë se kurrë, duhet të "veshin këpucët e njerëzve të zakonshëm" dhe të dinë të përcjellin informacione në një mënyrë që do të ishte më mikpritëse dhe e perceptuar si duhet nga audienca.

Mbetet e hapur pyetja, nëse autorët përdorin formulime më të kujdesshme në titujt e lajmeve të lartpërmendura, a do të shmangen veprimet e padëshiruara dhe të pamatura të qytetarëve?

Në të njëjtën kohë, raportimi për virusin e koronës në përmbajtjen gazetareske duhet të bazohet sa më shumë që të jetë e mundur në burimet zyrtare dhe përkatëse të informacionit, si në këtë rast:

Од Министерството за здравство информираа дека, поради огромна побарувачка на „сумамед“ во аптеките, тој е повлечен од слободна продажба и може да се добие исклучиво на рецепт и на товар на Фондот.

> **Ги чув овие информации и официјално, и од колегите фармацевти од аптеките. Најпрво еден многу сериозен апел до нашите граѓани, дека станува збор за терапија која во ниеден случај не би требало да ја користат на своја рака, особено имајќи во предвид дека токму оваа терапија, односно антибиотската терапија е многу важно да се прима со давање на соодветна индикација. Неправилната, неоправданата употреба на антибиотици којашто, можеби е и пракса во нашите простори, вклучително и на азитромицинот може да дојде до создавање на резистентност и неефикасност кон истиот кога навистина тој би требало да биде употребен. Дополнително, употребата или можеби идеите да некои пациенти примаат на своја рака ваков вид на терапија е исклучително ризична, имајќи во предвид дека може да биде дури и фатално кај некои од овие пациенти. Во таа конотација, навистина е можеби и добар чекорот којшто Министерството за здравство го направило за повлекување, односно рестриктирано давање на „сумамедот“, со цел да нема злоупотреба.**

Deklaratë nga prof. Dr. Alexandra Grozdanova, Kryetare e Komitetit për Imunizimit në Ministrinë e Shëndetësisë

Burimi: 360stepeni.mk

Raportimi në kushte të tilla të vështira të shkaktuara nga virusi korona nga një këndvështrim etik gazetaresk, parë realisht, është një detyrë komplekse. Gazetarët, nga njëra anë, duhet të tregojnë të vërtetën dhe të përçojnë informacionin përkatës, dhe nga ana tjetër, të mos provokojnë dhe përhapin shqetësime dhe ankth të panevojshëm në audiencë. Në të njëjtën kohë, fluksi në rritje i informacionit në lidhje me pandeminë është një sfidë për të gjithë punonjësit e mediave në kërkimin e tyre për informacionin. Sidoqoftë, pikërisht në këtë situatë ata duhet të tregojnë profesionalizëm, etikë dhe përgjegjësi për ta bërë më të lehtë dhe mëpak tëdhimbshme këtë kohë krize.

Autori:

Bojan Radeski, 16 vjet